



N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A.

RAPORT VJETOR 2022



RAPORTI VJETOR PËR AKTIVITETET E N.P.K. TRAFIKU URBAN SH.A. PËR VITIN 2022

Bordi i Drejtorëve të N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. miratoi Raportin Vjetor për vitin 2022 me nr. ~~339~~ në mbledhjen e mbajtur me datë: ~~15.03.~~ 2023.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	Jashar Sherifi , ud. Kryeshef Ekzekutiv	Valmira Uka, Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
Nënshkrimi:		
Data:	15.03.2023	15.03.2023



Përmbajtja:

Shkurtesat	5
HYRJE	6
Pasqyra e strukturës organizative të ndërmarrjes me të gjitha ndryshimet gjatë vitit 2022	7
I. PROFIL I SHKURTËR PËR NDËRMARRJEN.....	8
II. RAPORTI I UD KRYESHEFIT EKZEKUTIV.....	9
Avancimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve	10
Certifikimi i pagesave	11
III. DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	12
Performanca financiare e ndërmarrjes publike komunale “trafik urban” sha për periudhën 2018-2022.....	12
Planifikimi / Realizimi i të Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin 2022	15
IV. SEKRETARI – ZYRA LIGJORE	17
Numri total i akteve të brendshme të ndërmarrjes si dhe datat e miratimit	17
Marrëveshjet 2022	19
Shtojca 3. Sekretari/Zyra Ligjore/Burime Njerëzore	19
Burimet njerëzore	20
Statistika të përgjithshme	20
Protokolli dhe arkiva	22
V. DREJTORIA E OPERATIVËS.....	23
Sektori i transportit	24
Sektori i mirëmbajtjes	32
Sektori i shërbimeve mbështetëse.....	40
VI. DREJTORIA E PROKURIMIT	41
VII. Shtojcat	48
Shtojca A - Pasqyrat Financiare të Ndërmarrjes	48
Shtojca B - Hartat e Linjave	60

Shkurtesat

Lista e shkurtesave	
TU	Trafiku Urban
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KSHP	Kontrata për Shërbim Publike
KSHP (PSC)	Kontrata për Shërbim Publik (Public Service Contract)
BD	Bordi i Drejtorëve
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
ZAB	Zyrtari për Auditim të Brendshëm
ZKFTH	Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit
PF	Pasqyrat Financiare
PA	Pasqyra e te Ardhurave
PSH	Pasqyra e Shpenzimeve
LLP	Llogari e Pagueshme
LLA	Llogari e Arkëtueshme
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
LPP	Ligji i Prokurimit Publik

HYRJE

Raporti Vjetor për vitin 2022 është përpiluar në bazë të Nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Menaxhmenti i ndërmarrjes gjatë vitit 2022 ka punuar në mënyre efikase që të jemi të besueshëm dhe të respektuar, si dhe të jemi të krahasueshëm me ndërmarrjet tjera publike lokale në rajon. Profesionalizmi, integriteti, efikasiteti dhe përsosmëria e shërbimeve paraqesin vlerat tona të punës në ndërmarrje. Kemi përzgjedhur këto vlera sepse pasqyrojnë gjërat që ne besojmë se do të jenë më të rëndësishme, përdërisa përpigëmi të zbatojmë misionin tonë dhe të arrijmë vizionin tonë. Këto vlera që do të jenë të aplikueshme edhe gjatë viteve në vijim tregojnë mënyrën se si i trajtojmë udhëtarët tanë, partnerët e ndryshëm me të cilët punojmë si dhe stafin brenda ndërmarrjes.

Plani vjetor i punës i N.P.K. “Trafiku Urban” SH.A. për vitin 2022 është realizuar në bazë të objektivave të përcaktuara nga departamentet/njësitë përkatëse bazuar në planet e përcaktuara si dhe duke pasqyruar prioritetet strategjike të vitit 2022. Aktiviteti kryesor afarist i ndërmarrjes është transporti i udhëtarëve me 51 autobusë, si pjesë e transportit publik në Komunën e Prishtinës. Në tërësinë e tij, ky dokument paraqet aktivitetet e kryera gjatë vitit 2022 ku paraqiten tregues statistikorë mbi aktivitetin ekonomik, punësimin, të ardhurat e shpenzimet, operativen, investimet dhe të dhëna tjera specifike në lidhje me Trafikun Urban. Në vitin 2022, të hyrat e realizuara janë në vlerë prej 7.626,572 milionë. Realizimi i të hyrave vjetore kryesisht ka qenë i orientuar edhe në përmbushjen e objektivave të ndërmarrjes.

Viti 2022 e përcolli ndërmarrjen me ngritjen e çmimeve të derivateve, andaj kjo situatë detyrimisht në një masë ka shmangur realizimin e plotë të pikësnyimeve të planifikuara sipas planit të biznesit 2022 dhe planit zhvillimor të ndërmarrjes.

I. PROFIL I SHKURTËR PËR NDËRMARRJEN

N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. në Prishtinë ushtron veprimtarinë e transportit të udhëtarëve në linjat urbane dhe urbane-periferike me qëllim të organizimit të jetës dhe punës së qytetarëve dhe hyn në rangun e veprimtarive tjera shërbyese komunale. Për shkak të rëndësisë që ka ky shërbim i veçantë, ka filluar të kryhet në mënyrë të organizuar nga Komuna e Prishtinës që nga dt. 01.04.1976 kur ndërmarrja "Trafiku Urban" u themelua si Ndërmarrje Publike Komunale (N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A.). Ky organizim është ndërmarrë me qëllim që qytetarëve t'u ofrohet transport i organizuar, i cili do të ndikojë në siguri dhe zvogëlim të dendësisë së trafikut në rrugët e qytetit. Pas luftës së vitit 1999 ndërmarrja është regjistruar si subjekt afarist pranë administratës së përkohshme të OKB-së me dt. 22.06.2000 nën numrin e regj. 80060459 dhe është ri - regjistruar me dt. 22.06.2004 pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës me nr. e regj. të biznesit: 70163585 dhe nr. Unik identifikues 811289009, nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Bazuar në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/ L-111 të dt. 20.04.2012 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike Komunale nr. 03/ L-087 NPK "Trafiku Urban" SHA është regjistruar si Ndërmarrje Publike Komunale SH.A. në Prishtinë.

NR.	EMRI I NDËRMARRJES	NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE "TRAFIKU URBAN" SHA PRISHTINË
1.	Adresa	Rr. Tahir Zajmi nr. 43, 10 000 Prishtinë
2.	Themelimi	01.04.1976 – Prishtinë, me ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr.04/ L-111 është emërtuar si Ndërmarrje Publike Lokale.
3.	Themelues	Kuvendi Komunal i Prishtinës
4.	Prona	Pronë Publike Komunale
5.	Veprimtaria primare	Transporti i udhëtarëve në rrugët urbane dhe urbane-periferike të Prishtinës me rrethinë.
6.	Veprimtaria sekondare	Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve. Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to.
7.	Të punësuar	Ndërmarrja ka të punësuar 308 punëtorë të rregullt.
8.	Pasuria	Pasuria e patundshme është në proces të definimit të titullarit, ndërsa pasuria e luajtshme e ndërmarrjes përbëhet nga 51 autobusë urban, vetura, vegla, pajisje dhe makinat të punës për mekanikë.
9.	Menaxhimi	Ndërmarrja menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv, Bordi i Drejtorëve dhe mbikëqyret nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.
10.	Regjistrimi	Ndërmarrja mban regjistrimin e biznesit pranë MTI së Kosovës nr. regj. Biz. 70163585 dhe nr. Unik Identifikues: 811289009

II. RAPORTI I UD KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja Trafiku Urban gjatë kësaj periudhe ka vepruar me transparencë, raportim të shpenzimeve buxhetore të kryera gjatë vitit, evidentim të problemeve dhe marrje të masave konkrete për reduktimin e tyre në funksion të sigurimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit.

Ndërmarrja si rezultat të rritjes së performancës financiare ka rritur kapitalin e vet në kuadër të rritjes së vlerës për investimet e realizuara si dhe nga operimet e saj.

Megjithëse ka një strukturë shumë të madhe të financuar me borxh, ndërmarrja ka treguar aftësi financiare për të shlyer detyrimet financiare ndaj kreditorit. Ndërmarrja e ka të nënshkruar një kredi afatgjatë me BERZH, me garantues Komunën e Prishtinës.

Jemi munduar me përkushtimin të veprojmë sipas situatës se krijuar nga goditja e pandemisë, në mënyrë që operimi të vazhdon duke u përshtatur me situatën e krijuar e duke respektuar vendimet e institucioneve që me zgjuarsi të vazhdojnë aktivitetet e ndërmarrjes suksesshëm edhe në rrethanat e krijuara.

Ekipi BERZH (EBRD) të udhëhequr nga Xiaolu Wang, Bankiere e Asociuar (Associate Bankier) nga Ekipi i Infrastrukturës dhe Arianit Blakaj, Bankier Kryesor (Principal Banker) në bashkëpunim me ekipin e Komunës së Prishtinës kanë punuar intenzivisht vazhdimin e projektit për autobusët e ri në mbështetje të projektit të Qytetit drejt një sistemi të transportit urban më të organizuar dhe të besueshëm.

Gjatë kësaj konference u prezantua Plani i Veprimit për zhvillimin dhe nënshkrimin e PSC (Public Contract Service) me operatorët privat të autobusëve dhe rishikimi i kontratës aktuale me Trafikun Urban për të përfshirë 30 autobusët shtesë që do të blihen në bazë të projektit të ri, si dhe rishikimi periodik i azhurnimit të kostos aktuale të Kontratës Publike për Shërbim Publik (PSC). Po ashtu u diskutuan gjetjet kryesore të raportit teknik (Technical Due Diligence) për zgjerimin e flotës së autobusëve të Trafikut Urban dhe u diskutuan me Komunën hapat e ardhshëm për projektin e ri të autobusëve - Transporti Urban i Prishtinës II.

Me arritjen e marrëveshjes së kredisë me BERZH, Trafiku Urban do të prezantojë për herë të parë në Kosovë teknologjinë e autobusëve elektrikë dhe do të ndihmojë të reduktojë emetimet e gazeve në vend. Zgjerimi i flotës së autobusëve do të na mundësojë që t'u japim qytetarëve të Prishtinës një sistem transporti më eficient, më të besueshëm dhe më të sigurt. Nga tridhjetë autobusë gjashtë nga ta do jenë elektrik që do të operojnë përmes qendrës së qytetit dhe është vetëm hapi i parë i përpjekjes sonë për të kaluar në këtë mënyrë në tjetër nivel transporti."

Trafiku Urban do të përdorë kredinë për 30 autobusë, që përfshijnë 24 autobusë Euro VI dhe gjashtë të tjerë elektrikë, së bashku me infrastrukturën përcjellëse.

Të udhëhequr nga parimi i përmirësimit të vazhdueshëm, edhe gjatë këtij viti, jemi angazhuar në të gjitha dimensionet që reputacioni i TU të mos dëmtohet por të ngritët tutje, të ruhet ambienti miqësor brenda ndërmarrjes dhe të mbahet niveli i disiplinës së punonjësve për ta rritur efektshmërinë në punë.

Do t'i përmbahemi synimit që në mënyrë sa më profesionale ta përfaqësojmë ndërmarrjen në çdo aspekt.

UD i Kryeshefit Ekzekutiv Jashar Sherifi

Avancimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve

Trafiku Urban i kushton një rëndësi shumë të veçantë edhe avancimit profesional të punëtorëve. Përmes investimit të vazhdueshëm stafi ka fituar një ndjenjë më të lartë të kënaqshmërisë në punë, gjë që ka përmirësuar edhe motivimin e punëtorëve që drejtpërdrejtë ka ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në punë. Gjithashtu përmes trajnimeve të rregullta është krijuar mundësia për ta trajnuar stafin në fusha përkatëse, në mënyrë që të mund t'i plotësojnë kërkesat dhe rolin e tyre.

AVANCIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL	
Përshkimi	Institucioni
Mirëmbajtje e Licensës për Kontabilist të Certifikuar	IKAF
Mirëmbajtje e Licensave për Auditore të Brendshme	SCAAK
Zyrtar i Certifikuar për Menaxhimin e Financave Publike	IKAF
Siguria dhe Shëndet në punë	BLITERM.ING
Siguria dhe Shëndet në punë	BLITERM.ING
Teknik i Kontabilitetit	SCAAK

Ngjarjet gjatë vitit 2022:

- 🚧 Ndërmarrja ka menaxhuar dhe zbatuar të gjitha rregullat konform rekomandimeve të IKSHPK-së;
- 🚧 Menaxhimi i mirë i autobusëve ka qenë pandërprerë, përkundër vështirësive të punës me staf të reduktuar;
- 🚧 Shembull për ndërmarrjet dhe kompanitë e tjera për respektimin e masave kundër pandemisë;
- 🚧 Konfirmimin nga BERZH për raporte profesionale dhe miqësore të bashkëpunimit;
- 🚧 Ofrimi i informatave të nevojshme në kohë rekorde për konsulentët e BERZH-it rreth projektit të dytë të autobusëve;
- 🚧 Pagesat e rregullta mujore ndaj ATK-së për borxhet e grumbulluara ndër vite;
- 🚧 Mirëmbajtja e mirë teknike dhe higjienike e autobusëve për shërbim cilësor;
- 🚧 Investime në avancimin e punëtorëve dhe rritjen e mirëqenies së tyre.
- 🚧 Rritja e besueshmërisë për udhëtim me autobusët e Trafikut Urban.
- 🚧 Promovimi i punësimit për personat me aftësi të veçanta.
- 🚧 Mbajtja e trajnimeve të stafit dhe zhvillimi i aftësive të punonjësve;

Në kuadër të Zyres së Kryeshefit Ekzekutiv bëjnë pjesë:

Asistente Ekzekutive e Kryeshefit, Zyrtari Certifikues, Përgjegjës për Siguri dhe Shëndet në Punë, Zyrtare për Informim/Zëdhënëse, Shofer i Kryeshefit Ekzekutiv dhe Përgjegjësi i Kontrollës së Brendshme Inspektuese.

Certifikimi i pagesave

Edhe në vitin 2022 Trafiku Urban, ka certifikuar realizimin e shpenzimeve buxhetore përmes prokurimit të N.P.K. TRAFIKU URBAN SHA. Me certifikimin e lëndëve jemi të siguruar që kushtet e zbatueshmërisë të një kontrate publike janë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës dhe gjithashtu që shpenzimi i parasë publike sipas kontratave publike është bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Certifikimi i lëndëve nënkupton që llogaridhënia e projekt menaxherëve është më e madhe, shpenzimet përmes prokurimit janë të kontrolluara dhe mbahet evidencë më kuptimplotë e aktiviteteve.

Gjatë vitit 2022 janë certifikuar gjithsej 136 lëndë.

III. DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Performanca financiare e ndërmarrjes publike komunale “trafiku urban” sha për periudhën 2018-2022

Pasqyra e performancën financiare të ndërmarrjes për periudhën pesë vjeçare ka për qëllim informimin e palëve të interesuar të brendshme dhe të jashtme. Performanca e ndërmarrjes do të paraqitet përmes zërave kryesorë të pasqyrës së pozitës financiare dhe pasqyrës së performancës financiare: pasuritë, detyrimet, ekuiteti, të hyrat dhe fitimi/humbja neto në mënyrë tabelore për pesë vitet prej 2018-2022.

Nr	Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1	Asetet	13,786,277	13,339,590	12,796,583	12,108,352	10,612,337
2	Detyrimet	13,174,088	10,209,884	9,368,608	7,888,591	6,625,973
3	Kapitali/Ekuiteti	612,189	3,129,706	3,427,978	4,219,762	3,986,364
4	Totali i të Hyrave	2,313,172	6,138,988	5,998,945	7,285,564	7,626,573
5	Fitimi/ Humbja Neto	848,284	902,236	494,403	791,784	233,398

Tabela 1 Treguesit e performancës financiare 2018-2022 NPK Trafiku Urban SHA

Nr	Përshkrimi	Raporti i rritjes 2019/2018	Raporti i rritjes 2020/2019	Raporti i rritjes 2021/2020	Raporti i rritjes 2022/2021
1	Asetet	3.24%	-4.07%	-5.38%	-12.33%
2	Detyrimet	22.50%	-8.24%	-15.80%	-16.07%
3	Kapitali/Ekuiteti	-411.23%	9.53%	23.1	-5.37%
4	Totali i të Hyrave	-165.39%	-2.28%	21.45	4.68%
5	Fitimi/ Humbja Neto	-6.36%	-45.20%	60.15	-71.39%

Tabela 2 Raportet e performancës financiare 2018-2022 NPK Trafiku Urban SHA


Tabela numër 1 na tregon performancën financiare të viteve 2019-2022 dhe shohim se kemi një rënie të treguesi financiar Asetet e ndërmarrjes. Viti 2018 na tregon një performancë më të mirë sepse në këtë vit është kompletuar flota e autobusëve prej 51 sa janë tani dhe ky numër nuk ka ndryshua, ndërsa vlera e aseteve është në rënie për shkak të amortizimit të aseteve. Raporti i performancës është në rritje të treguesi i të hyrave operative, të cilat kanë trend rritës për periudhën 2020-2022 në mënyrë konstante.

Grafiku nr. 1 tregon lëvizjen grafike të totalit të pasurive dhe shohim një rënie prej vitit në vit, e cila tregon që viti 2018 është viti i performancës më të lartë të këtij treguesi, në këtë vit është kompletuar flota e autobusëve dhe rënia tregon amortizimin e ndodhur çdo vit.




Grafiku 1 Totali i pasurive dhe trendi lëvizës 2018/2022 NPK Trafiku Urban SHA

Grafiku numër 2 tregon lëvizjen grafike të total detyrimeve dhe shohim një performancë mjaftë të mirë të këtij treguesi, i cili pasqyrohet sidomos në vitin 2022, dhe konkludojmë se vlera e detyrimeve është zvogëluar dukshëm.




Grafiku 2 Totali i detyrimeve dhe trendi lëvizës 2018/2022 NPK Trafiku Urban SHA

Grafiku numër 3 tregon lëvizjen grafike të total kapitalit/ekuitetit të viteve 2018/2022. Efekti neto i pasurive dhe detyrimeve tregohet nga ekuiteti, i cili performancën më të mirë e ka arritur në vitin 2021 dhe tregon një rënie të lehtë në vitin 2022.




Grafiku 3 Totali i kapitalit/ekuitetit dhe trendi lëvizës 2018/2022 NPK Trafiku Urban SHA

Grafiku numër 4 tregon lëvizjen grafike të total të hyrave për vitet 2018/2022 dhe shohim një trend rritës të këtij treguesi.



Grafiku 4 Totali i të hyrave dhe trendi lëvizës 2018/2022 NPK Trafiku Urban SHA

Grafiku numër 5 tregon lëvizjen grafike të total fitimit/humbjes neto dhe trendit linear të kësaj lëvizjeje për vitet 2018/2022.



Grafiku 5 Totali i fitimit/humbjes neto dhe trendi lëvizës 2018/2022 NPK Trafiku Urban SHA

Menaxhmenti i NPK Trafiku Urban SHA përkundër devijimit në planifikim për shkak të faktorëve të jashtëm global, vazhdon të ofroj shërbime cilësore për qytetarët e Prishtinës duke reflektuar në rritjen e të hyrave operative si dhe menaxhimin sa më efikas të shpenzimeve deri në pikën ku nuk e pengon procesin e punës.

Planifikimi / Realizimi i të Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin 2022

Të Hyrat e planifikuara/realizuara		01.01.2023-31.12.2023		
Emërtimi	Të planifikuara	Të realizuara	Ndryshimi në Euro	Ndryshimi në%
Gjithsej të hyrat	7,538,148.00	7,626,573.00	88,425.00	1.17

Të hyrat e planifikuara për vitin 2022 edhe pas rishikimit kanë qenë 7,538,148.00 euro, ndërsa realizimi është 7,626,573.00 euro, për 88,425.00 euro më shumë ose 1.17%.

Shpenzimet e planifikuara/realizuara				
01.01.2022-31.12.2023				
Emërtimi	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet e realizuara	Ndryshimi në Euro	Ndryshimi në%
Shpenzime të naftës	2,394,863	2,554,898	160,035	6.26
Shpenzime të fluideve	116,820	95,494	-21,326	-22.33
Shpenzime të mirëmbajtjes dhe autopjesëve nga operativa Komunali	417,089	323,646	-93,443	-28.87
Shpenzimet për pagat e personelit	18,950	18,581	-369	-1.99
Shpenzimet tjera financiare administrative dhe operative	3,273,222	3,270,120	-3,102	-0.09
Gjithsej shpenzimet	7,088,024	6,758,548	-329,476	-4.87

Shpenzimet e planifikuara edhe pas rishikimit kanë qenë gjithsej 7,088,024.00 euro, ndërsa janë realizuar 6,758,548.00 dhe kemi një realizim për 329,476.00 euro më pak ose prej 4.87%. Kjo

nënkupton se në vitin 2022 edhe përkundër rritjes së çmimeve, ka ndodhur një racionalizim i jashtëzakonshëm i shpenzimeve, përveç shpenzimit të naftës, të cilin kemi pësuar një devijim prej një milion euro nëse e krahasojmë me planifikimin para rishikimit, sepse është planifikuar me 1 euro çmimi i naftës dhe rritja ka kaluar afër 100%, menaxhimi ka qenë i mirë qeverisur nga ana e menaxhmentit dhe i mirë mbikëqyrur nga ana e bordit të drejtorëve dhe kemi arritur që pa i dëmtuar ose ulur cilësinë e shërbimeve t'i ulim shpenzimet për 4.87% dhe të i rrisim të hyrat prej 1.17%.

IV. SEKRETARI – ZYRA LIGJORE

Në bazë të nenit 31.3 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nenit 5 të Rregullores nr.1075 të datës 21.08.2017 të Punës së Bordit të Drejtorëve, Sekretari i Ndërmarrjes Publike Komunale “Trafiku Urban” SH.A, paraqet raportin vjetor të punës për periudhën kohore nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022.

Në këtë raport vjetor 2022 janë të përfshira: Aktet e brendshme të Ndërmarrjes, Kontratat, Organizimi i Zyres Ligjore dhe Burimeve Njerëzore, Struktura Organizative e ndërmarrjes, Procedurat Gjyqësore etj.

Gjithashtu, më datë: 08.12.2021 është bërë plotësim-ndryshimi i Statutit të Ndërmarrjes e i cili pritet të miratohet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.

Takimet e bordit	Numri i takimeve	Numri i pjesëmarrjes së drejtorëve në takime të bordit
Takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve	15 mbledhje të BD 1 mbledhje e jashtezakonshme 10 mbledhje te KA	<ul style="list-style-type: none"> • Kryesuesi, • 3 Drejtorë të Bordit, • Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e • Këshilltari i Përgjithshëm/ Sekretari i Ndërmarrjes, • Zyrtar/ja i/e Auditimit dhe • ZKFTH

Numri total i akteve të brendshme të ndërmarrjes si dhe datat e miratimit

Aktet e Brendshme të cilat janë miratuar në Bordin e Drejtorëve të Trafikut Urban gjatë vitit 2022 janë:

Nr.	Emri	Data	Koment
1	Organogrami i ri i Ndërmarrjes	25.11.2021	Miratuar

Lista e përgjithshme e akteve të brendshme të ndërmarrjes ndër vite:

Nr.	Emri	Data
1	Statuti	25.09.2013
2	Rregullore e Punës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit	21.08.2017
3	Rregullore e Marrëdhënies së Punës/ Politika-Procedurat e Personelit	21.08.2017
4	Rregullore mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale	22.02.2018
5	Kodi i Sjelljes dhe Etikës	22.02.2018

6	Rregullore për Arkivin dhe Lëndën Arkivore	31.05.2018
7	Rregullore për mbajtjen e Dosjeve Personale të Punëtorëve	31.05.20218
8	Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës	24.09.2018
9	Rregullore për Paga	30.01.2019
10	Rregullore për Financa dhe Kontabilitet	25.02.2019
11	Kriteret, Procedurat dhe Niveli i Kompensimit të Dëmeve	13.03.2019
12	Rregullore për Orarin e Punës	19.03.2019
13	Rregullore për Pensionim të Parakohshëm	09.09.2019
14	Politika e Sigurisë, Shëndetit, Aspekti Social dhe Kujdesi ndaj Mjedisit	08.10.2019
15	Vlerësimi i Rrezikshmërisë për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	14.10.2019
16	Plani i Reagimit Emergjent për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	14.10.2019
17	Plani për Menaxhimin e Mbeturinave	27.11.2019
18	Plani për Menaxhimin e Vajrave dhe Derivateve	27.11.2019
19	Rregullore për Menaxhimin e Stokut	27.11.2019
20	Menaxhimi i Baterive (akumulatorëve) të Përdorura	27.11.2019
21	Menaxhimi i Gomave të Përdorura	27.11.2019
22	Deklarata e Vlerësimit të Riskut për Pozitën “Automekanik”	Qershor 2019
23	Deklarata e Vlerësimit të Riskut për Pozitën “Punëtor Sigurimi”	Qershor 2019
24	Deklarata e Vlerësimit të Riskut për Pozitën “Shofer”	Qershor 2019
25	Procedura për Menaxhimin e Çelësave	26.05.2020
26	Programi i Trajnimeve të Punëtorëve në TU	24.11.2020
27	Rregullore për pëdorimin e automjeteve zyrtare	18.05.2021
28	Organogrami i ri i Ndërmarrjes	25.11.2021
29	Statuti i ndërmarrjes	16.09.2022
30	Rregullore për paga dhe kompensime të tjera	26.08.2022
31	Rregullore për sistematizim të vendeve të punës	13.07.2022
32	Rregullore nr.02/2022 e Punës së Bordit të Drejtorëve dhe KA	26.08.2022
33	Plotësim ndryshimi i statutit	30.12.2022

Marrëveshjet 2022

Më poshtë janë paraqitur kontratat/marrëveshjet që "TU" ka lidhur me palët e treta gjatë vitit 2022:

Nr.	Pala	Përshkrimi
1	Aeroporti "Adem Jashari"	Marrëveshje me aeroportin nr.1051 dt. 29.04.2022.
2	European Bank for Reconstruction and Development	Marrëveshje me Banken Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim, marrja e kredisë për blerjen e autobusëve – nr. port 4158 dt. 19.12.2022
3	Qendra e Kompetences "Shtjefën Gjeqovi" Prishtinë	Marrëveshje nr. port 3299 dt. 20.10.2022

Proceset Gjyqësore

Shtojca 3. Sekretari/Zyra Ligjore/Burime Njerëzore

Tabela e lëndëve gjyqësore në procedurë

Nr.	Nr. i Lëndës	Lloji i Lëndës	Procedura
1	P.nr.145/18, PPP.nr.111/2018	Civile	Gj. Themelore
2	C.nr.2771/14	Civile - Paga borxh	Gj.Apelit
3	C.nr.1142/19	Civil - Paga borxh	Gj.Themelore
4	Padia nr.57 e dates 23.01.2018	Civil - Kompensim demi	Gj.Themelore
5	P.nr.1988/18 dhe PPP.nr.1076/18	Civil - Paga borxh	Gj.Apelit
6	C.nr.192/15	Civil - Paga borxh	Gj.Apelit
7	C.nr. 2404/17	Civil - Paga borxh	Gj.Themelore
8	K.nr.5582/17	Kundervajtje	Gj.Apelit
9	C.1724/19	Civil - Paga borxh	Gjykat Apelit
10	Cp.nr.2349/19	Permbarimore	Gjykat Apelit
11	Inspektorat I Punës	Konflikt Administrativ	Gjykat Themelore
12	C.nr.3683/19	Civil - Borxh per shitblerje	Gjykat Themelore
13	2020-AD-3583 (Denoncim në Polici)	Penale	Polici
14	C.nr.1715/18	Civile	Gj.Themelore
15	C. nr. 3159/20	Civile - Diferenc në Paga	Gj.Themelore
16	"Eurosig"	Kompenzim dëmi	Gj.Themelore
17	C.nr.3694/18		Gjykat Apelit
18	C.nr.1207/21	Caktim I Masës së Sigurisë	Gj.Themelore
19	I.P. 01 nr.12-142/21	Ankes ndaj Konkursit	Inspektoriati I Punës
20	C.nr.1908/18	Kompenzim i Trustit Pensional	Gj.Themelore
21	C.nr.2272/21	Kundër Vendimit për shkëputje të kontratës	Gj.Themelore
22	C.nr.4035/2022	Kundër Vendimit për shkëputje të kontratës	Gj.Themelore

Lëndët gjyqësore të përfunduara gjatë periudhës raportuese

Nr.	Nr. i Lëndës	Lloji i Lëndës	Data e vendimit
1	C.nr.2793/12	Gj.Themelore	23.02.2022
2	C.nr.7940/2021	Gj.Themelore	26.04.2022
3	C.nr.1812/11	Gj.Themelore	06.05.2022
4	A.nr.506/19	Gj.Themelore	16.05.2022

Inspektorati i Punës

Gjatë periudhës së vitit 2022 në Inspektoratin e Punës janë trajtuar gjithsej 16 raste.

Burimet njerëzore

- Konkurset e punës të hapura nga TU në vitin 2022 janë gjithsej 37 konkurse për 42 pozita.
- Angazhimi i punëtorëve për punë praktike gjatë vitit 2022 nuk ka pasur
- Angazhimi punëtorëve të jashtëm si konsulentit ligjor gjatë vitit 2022 ka qenë 1 punëtor me kontratë mbi vepër.
- Punësimet të reja nga jashtë gjatë vitit 2022 janë 42 punëtorë.
- Gjatë vitit 2022 kemi pasur 14 lëvizje të punëtorëve në pozita të ndryshme brenda ndërmarrjes.
- Gjatë vitit 2022 kemi pasur 18 shkëputje të kontratave.

Statistika të përgjithshme

Numri total i punëtorëve deri më 31.12.2022

PUNËTORË	398
Aktiv	392
Pasiv	6
Ndarja sipas departamentit / zyrës / sektorit	
Zyra e kryshefit/es	16
Sekretari	/
Auditori	/
Drejtoria e Prokurimit	2
Zyra e Financave	15
Drejtoria e Administratës	18
Drejtoria e Operativës	341
Pensionim i Parakohshëm	6
Kontrata	398

Nga tabelat e mësipërme, kuptojmë që numri total i punëtorëve është 398 në total, prej tyre 392 punëtorë aktiv, ndërsa 6 punëtorë janë pasiv (pensionim i parakohshëm)

	F	M	Total
Komunitete jo-shumicë	2	6	8
Persona me aftësi të kufizuar	2	2	4

Ndarja e punëtorëve sipas moshës dhe gjinisë

	Mosha	M	F	Gjithsej
1	18 - 25	21	1	22
2	26 - 35	84	12	96
3	36 - 45	105	12	117
4	46 - 55	76	10	86
5	56 - 65	72	5	77
	Gjithsej	358	40	398

Ndarja e punëtorëve sipas arsimimit

	Niveli i Arsimimit	M	F	Gjithsej
1	Shkollim i Lartë	24	21	45
2	Shkollim i Mesëm	318	16	334
3	Shkollim Fillor	18	1	19
	Gjithsej	358	40	398

Punëtorë në pensionim të parakohshëm	6
Punëtorët në pushim pa pagesë	0
Punëtorët që kanë ndërruar jetë	1

Protokolli dhe arkiva

Protokollimi i shkresave

Për dallim nga viti 2017 ku janë protokolluar gjithsej 2030 shkresa, në vitin 2018 janë protokolluar 3372, në vitin 2019 janë protokolluar gjithsej 4701 shkresa, në vitin 2020 janë protokolluar gjithsej 3464 shkresa, në vitin 2021 janë protokolluar gjithsej 3598, ndërsa në vitin 2022 janë protokolluar gjithsej 4374 shkresa. Kjo statistikë tregon që ndërmarrja ka shtuar ndër vite intensitetin e punës. Protokollimi mbahet dhe në formën elektronike përveç mënyrës fizike, si dhe bëhet skenimi i të gjitha shkresave të pranuar në protokoll.

Rrjedha e protokollit ndër vite

Viti	Nr. i lëndëve të protokolluara
2017	2030
2018	3372
2019	4701
2020	3464
2021	3598
2022	4375

V. DREJTORIA E OPERATIVËS

DREJTORIA E DEPARTAMENTIT TË OPERATIVËS

Departamenti i Operatives përfshinë pjesën më të madhe të të punësuarve të ndërmarrjes (rreth 85% të punëtorëve janë të angazhuar me punë brenda Departamentit të Operatives) dhe si i tillë e bartë pjesën më të madhe të punëve dhe aktiviteteve brenda TU.

Qarkullimi realizohet në 7 linja: Linja 1, 1A, 3, 3C, 4, 7C dhe 15.

Të gjitha linjat dhe oraret janë të evidentuara në aplikacionin për monitorim të brendshëm si dhe në aplikacionin për lokalizim të autobusëve që u mundësohet në kohë reale qytetarëve.

PËRMBLEDHJA E AKTIVITETEVE TË DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË OPERATIVËS

- Takime me BERZH lidhur me finalizimin e kontratës së kredisë.
- Takime me DSHP për riorganizimin e linjave që nuk do të kalojnë deri me 08.01.2023.
- Udhëtimi për nënshkrimin e kontratës së kredisë në Londër.
- Takime N.P. “Tetova Transport” ku shkëmbyem përvojat e të dy ndërmarrjeve dhe premtuam bashkëpunim në çdo aspekt.
- Kemi përfunduar vlerësimin e performancës për punëtorët Departamentit të Operatives.
- Takim me DSHP lidhur me situatën e krijuar pas mbylljes së rrugës Xhorxh Bush.
- Kemi dërguar në BERZH plani e prokurimit ku është një hap tjetër për finalizimin e dokumentit për nënshkrim të kontratës së kredisë.
- Ne gjithashtu kemi përfunduar edhe planifikimin buxhetore dhe Planin e biznesit për 3 vitet e ardhshme pra 2023-2025.
- Për shkak të ankesave të shumta nga ana e qytetarëve për nr. të madh të qytetarëve që hyjnë në autobusë, ne kemi vendosur që të shkëpusim marrëveshjen për transport të punëtorëve të tyre që kemi pasur me Këshillin Prokurorial dhe atë Gjyqësore, dhe tani do të kemi edhe ata dy autobusë në shërbim të qytetarëve në pikat e fluksit më të madh të ditës.
- Kemi pasur nga DSHP - Komuna e Prishtinës furnizim me poçe LED ku është rregulluar një problem i madh në garazhet e TU sa i përket ndriçimit.
- Kemi pasur takim me delegacionin e JICA –Japoneze
- Kemi përgatitur hartën e rrjetit të linjave të Transportit Publik të Prishtinës me qëllim të ofrimit të shërbimit të transportit për të gjithë qytetarët.
- Vendosja e shenjave njoftuese në hyrje të autobusit për qytetarët se çka nuk lejohet të mbajnë me vete në autobus.
- Përfundimi dhe vendosja e foljeve vetëngjitëse në tabelat ku janë vendosur në qytet dhe aeroport e orarit të autobusëve Prishtinë – Aeroport dhe e kundërta.
- Patëm takim me kompaninë e kontraktuar nga USAID lidhur me studim të fizibilitetit nga ana e kësaj kompanie për kogjenerim të energjisë përmes paneleve solar dhe tani pritet që të

nënshkruhet një marrëveshje në mes të Trafikut Urban dhe USAID për fillimin e këtij studimi ku USAID do të jenë investitorë.

- Shtypja e biletave boshe dhe vazhdimi sipas planifikimit.
- Kemi pasur në vizitë studentet nga Universiteti Teknik Dresden (Gjermania) qëllimi ishte që të njoftohen me transportin publik në Prishtinë.
- Kemi pasur takim në zyrat e TU me menaxherët e BERZH që vizituan Prishtinën, ku njëherit diskutuam për procesin e blerjes së autobusëve, ata ishin shumë të kënaqur me punën tonë dhe seriozitetin tonë që kemi shfaqur gjatë kësaj periudhe kur janë blerë autobusët e parë e deri tash.
- Ne gjithashtu patëm takim me Bankën Botërore lidhur me korridorin M9 F. Kosove e deri në Bardhosh që ishte vazhdimësi e takimit të mëhershëm, ku tema ishte se si të zvogëlohet përdorimi i veturave në këtë korridor dhe siguria e qytetareve që përdorin këtë rrugë.
- Ne gjithashtu kemi përfunduar edhe planifikimin buxhetore dhe Planin e biznesit për 3 vitet e ardhshme pra 2023-2025.
- Pas disa kërkesave tona për intervenim në Bardhosh rr. “Skënderbeu”, NPB ka intervenuar dhe ka sanuar gropat që na kanë sjellë shumë telashe në autobusët e ndërmartjes dhe tani jemi të kënaqur me këtë veprim.

Sektori i transportit

nr.	Raport për punët e realizuara në Sektorin e Transportit
1.	Përgatitja e planit të operimit në linjat e TU-së për vitin 2022
2.	Përgatitja e planit kalendarik për angazhimin e ekuipazhit të autobusëve
3.	Përgatitja dhe realizimi i planit për menaxhimin e shfrytëzimit të pushimeve vjetore
4.	Përgatitja e kalendarit për kontrole teknike të rregullta dhe periodike të automjeteve
5.	Procedurat e administrimit të sigurimeve të flotës së autoparkut
6.	Menaxhimi i kontratës PSC duke përfshirë përgatitjen e procesverbalit për kilometrat e gjeneruara sipas planit të operimit, përgatitja e procesverbalit për matjen e indikatorëve të performancës.
7.	Organizimi i bashkëbisedimeve me ekuipazhin e autobusëve për parregullsitë dhe ngritjen e imazhit të TU-së
8.	Takimet e rregullta ditore me Inxhinierin e Komunikacionit si dhe dispeçeret kryesor për diskutimin dhe zgjidhjen e problemeve gjatë procesit të operimit në linja
9.	Njoftimi i ekuipazhit për sezonin e bartjes së uniformave të punës si dhe furnizimi me uniforma verore dhe dimërorë
10.	Trajnimi i stafit të ri për rregullat dhe mirësjelljen gjatë orarit të punës

11.	Përgatitja e planit për matjen e performancës së punëtorëve për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2022
12.	Pjesëmarrja në takime dhe grupe punuese të organizuara nga institucionet shtetërore dhe organizatat e ndryshme
13.	Menaxhimi i procedurave për administrimin e lëndëve të aksidenteve
14.	Menaxhimi i procedurave për dorëzimin e video incizimet e autobusëve sipas kërkesave të organeve shtatore
15.	Sektori i Mirëmbajtjes ka pasur shumë vështirësi gjatë vitit për shkak të mungesës së numrit të lartë të punëtorëve. Kjo gjë ndikon në performancën dhe kohën e reagimit si dhe në rritjen e amortizimit të flotës së autobusëve.
16.	Përgatitja e ndryshimit të operimit në linja sipas kërkesave nga organet komunale që përfshinë zgjatjen e orarit të qarkullimit të autobusëve deri në orën 24 në linjat 1,1A,3 dhe 4.
17.	Përgatitja e njoftimeve për qytetarë në lidhje me devijimet apo ndryshimet e rendit të udhëtimit të linjave për shkak të natyrave të ndryshme

Realizimi i planit të nisjeve


Gjatë vitit 2022 janë planifikuar gjithsej 266,214.00 nisje për ose shprehur në kilometra 3,509,820.00 (km), duke u bazuar në planin e menaxhimi të kontratës së PSC si dhe planin e operimit të autobusëve në transportin publik në komunën e Prishtinës me gjithsej 8 linja me 51 autobusë.

Në bazë të tabelës së më poshtme mund të konstatojmë se mesatarja brenda viti 2022 është realizuar me një përqindje të lartë 99.58 % e realizimit të planit të operimit, mos realizimi 100% i planit ka ardhur si pasojë e bllokimit të rrugëve (rregullimin e infrastrukturës nga ana e Komunës), vonesat në rrugëtim (për shkak të komunikacionit të ngarkuar-ngopur) dhe për shkak të aksidenteve të autobusëve.

Totali i realizimi të kilometrave të autobusëve -2022

Nr.	Muajt	Nisje e planifikuara	Të Realizuara	Dallimi (nisjeve)	Përqindja e realizimit
1	Janar	285,505.00	284,615.00	-890.00	99.69%
2	Shkurt	264,135.00	259,935.00	-4,200.00	98.41%
3	Mars	294,044.00	293,594.00	-450.00	99.85%


4	Prill	277,629.00	276,529.00	-1,100.00	99.60%
5	Maj	289,834.00	289,034.00	-800.00	99.72%
6	Qershor	285,207.00	284,257.00	-950.00	99.67%
7	Korrik	294,671.00	293,921.00	-750.00	99.75%
8	Gusht	313,892.00	313,142.00	-750.00	99.76%
9	Shtator	299,722.00	298,198.00	-1,524.00	99.49%
10	Tetor	302,652.00	302,003.00	-649.00	99.79%
11	Nëntor	299,296.00	297,783.00	-1,513.00	99.49%
12	Dhjetor	303,233.00	302,632.00	-601.00	99.80%
TOTAL		3,509,820.00	3,495,643.00	-14,177.00	99.58%



Totali i realizimi të nisjeve të autobusëve -2022

Nr.	Muajt	Nisje e planifikuara	Të Realizuara	Dallimi (nisjeve)	Përqindja e realizimit
1	Janar	22,126.00	22,045.09	-80.91	99.63%
2	Shkurt	20,418.00	20,036.18	-381.82	98.13%
3	Mars	22,916.00	22,875.09	-40.91	99.82%


4	Prill	21,504.00	21,404.00	-100.00	99.53%
5	Maj	22,284.00	22,211.27	-72.73	99.67%
6	Qershor	22,136.00	22,049.64	-86.36	99.61%
7	Korrik	22,442.00	22,373.82	-68.18	99.70%
8	Gusht	22,916.00	22,847.82	-68.18	99.70%
9	Shtator	22,136.00	21,997.45	-138.55	99.37%
10	Tetor	22,600.00	22,541.00	-59.00	99.74%
11	Nëntor	22,136.00	21,998.45	-137.55	99.38%
12	Dhjetor	22,600.00	22,545.36	-54.64	99.76%
	TOTAL	266,214.00	264,925.18	-1,288.82	99.50%



AKSIDENTE GJATË VITI 2022


Numri i përgjithshëm i rasteve që janë trajtuar për periudhën e raportimit ka qenë: 252 lëndë (raste)

Nr. i lëndëve për vitin 2022	
Aksidente	190
Aksidente me lëndime	3
Dëmtime	19
Dënime nga Policia	0
Incidente	40
Totali	252




Ndarja e lëndëve në bazë të përgjegjësit (procedurat) e rasteve për trajtim të mëtutjeshme

Ndarja në grupe për përgjegjësit (Procedura) e lëndëve:	
Kompani të Sigurimeve	85
Godit dhe ik	5
Në pritje të gjyimit (Gjykatë, Komisioni Policor)	1
Pala e tretë	45
Gjobë në trafiku	0
BUS-BUS	3
Shoferë	113
Total	252




Lëndët e kërkesave për dëmshpërblime të aksidenteve pranë kompanive të sigurimeve :

Kompanitë e Sigurimeve	
Marrëveshje të arritura (Procedura jashtëgjyqësore)	68
Lënde në procedura	16
Lënde me ankimim në proces Gjyqësor	1
Total	85




Analiza e aksidenteve, incidenteve dhe dëmtimeve në autobusë të cilët hyjnë në kategorinë ku potencialisht ose procedurat vazhdojnë vetëm për shoferet TU-së për përcaktim të fajësisë ose jo fajësisë

LËNDËT	
Lëndët në procedura të komisionit	108
Vërtetimi i fajësisë së shoferëve	8
Vërtetimi i jo fajësisë së shoferëve	0
Lëndët e fajësisë së papërcaktuara	0
Total	116



Nëse analizojmë numrin total të aksidenteve, incidentev dhe dëmtimeve ku shoferët tonë janë me procedura të brendshme të TU-së dhe numrin total të aksidenteve të shaktuar nga palët e treta, raporti është si me poshtë:

Aksidentet me palët e treta dhe procedurat e brendshme mbi shoferet e TU	
Aksidentet me procedura të brendshme pranë TU-së	116
Kompani të Sigurimeve, Palët e treta, Godit dhe Ik	136
Total	252



Menaxhimi i pushimeve vjetore


Pushimet vjetoret për punëtorët e sektorit të transportit që përfshinë: Udhëheqësin e Transporti, Inxhinierin e Komunikacionit, Zyrtarin për GPS dhe Kamera, Dispeçerët e Kryesor, dispeçerët e linjës, Shoferet dhe Konduktet që në total arrijnë shifrën 278 punëtorëve është realizuar 85% i plani i shfrytëzimit të pushimeve vjetore ashtu siç e parashih ligji i punës.

Qasja në kamerat e autobusit

Autobusët e Trafikut Urban kanë gjithsej gjashtë kamera të cilat kapin pamje të komplet hapësirës së brendshme të autobusit dhe jashtë tij, duke parë këtë përparësi të cilën e kanë autobusët tonë është paraqitur nevoja për qasje në kamera me kërkesa zyrtare, për rastet si me poshtë:

- Verifikim i situatave të ndryshme pas ankesave të qytetarëve për mos kujdes nga personeli i TU.
- Kërkesa nga Policia e Kosovës për raste të ndryshme.

PERIUDHA/ Viti 2022	Nr. I kërkesave
MENAXHMENTI	54.0
POLICIA	81
TOTAL	135.0




Menaxhimi i ankesave

Sektori i Transportit është i përfshirë drejtpërdrejt me qendrën e pranimit të thirrjeve telefonike.

Zyra e dispeçerëve pranon thirrje gjatë gjithë orarit të punës dhe jep informata të shpejta për shërbimet e transportit, pranon dhe delegon ankesat pran zyrtareve kompetent për shqyrtimin e ankesave.

Mund të konstatojmë se mesatarja e thirrjeve gjatë një dite arrijnë deri në 30-40 thirrje telefonike dhe po të njëjtin numër e kemi edhe mesazhet ne aplikacionin viber, të cilat sipas informata të cilat kërkojnë dhe i ofrohen qytetarëve mund të ndajmë në:

- Pyetje për shërbime e transportit (orari i nisjeve, arrijtjet në stacionet e caktuara, vonesat, etj),
- Ankesat ndaj personelin (vojitje jo e rehatshme, vojitje të shpejta, sjellje jo e mirë, etj),
- Informata mbi biletat.



Sektori i mirëmbajtjes


1. Sektori i Mirëmbajtjes ka implementuar me sukses të plotë Kalendarin e Mirëmbajtjes të vitit 2022. Mbi 100 kampanja të mirëmbajtjes preventive janë organizuar përgjatë 12 muajve. Realizimi i këtyre aktiviteteve tregon se Sektori i Mirëmbajtjes i ka përfunduar shumë suksesshëm objektivat.

KALENDARI I PUNËVE NË SEKTORIN E MIRËMBAJTJES PËR VITIN 2022 Sektori i Mirëmbajtjes												
JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	
1	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE	KONTROLLIMI AUTOBUSËVE PËR GJENDJEN E RRIPAVE TE MOTORËVE, PULEKOHJE, NIVELIN E FLUIDIT FTOHËS DHE VALJAVE / ODO FUNDJAVE
